

## **THE CONTRIBUTION OF FAIK MUSTAFA IN THE ORGANIZATION OF THE DECEMBER 1968 DEMONSTRATES IN TETOVO**

**Nebi Dervishi**

### **Abstract**

Faik Mustafa was the organizer and promoter of the Demonstrations of 22-23.11.1968 in Tetovo. Being too modest, often during conversations, he claimed that the organizers of the 1968 Demonstrators were the people.

Faik Mustafa, as the organizer of the Demonstrators, he was imprisoned and sentenced for 5 years and a half (5.5 years). After three years of imprisonment, he continued his studies in Prishtina, where he graduated in 1975.

As a student in Pristina, he was able to work as a journalist in the newspaper "Bota e re", but after three years, he and the whole editorial staff would be laid off. After that he was employed in the daily "Rilindja" (upon an open call), where he wouldn't be allowed to continue working on basis of being a former convict, and due to absence of moral - political qualities.

Based on the available data, this paper aims to shed light on the most iconic figures of the 1968 events in Tetovo, and as a modest effort it aims to emphasize the ideas that coincide with the national activity of Albanians of Macedonia in the former federal system of Yugoslavia.

**Key words:** Faik Konica, Albanian newspapers, prison.

## **KONTRIBUTI I FAIK MUSTAFËS NË ORGANIZIMIN E DEMOSTRATAVE TË DHJETORIT TË VITIT 1968 NË TETOVË**

**Nebi Dervishi**

### **Abstrakt**

Faik Mustafa ka qenë figura emblemore në organizimin e demonstratave të datave 22-23.12. 1968 në Tetovë. Përtej faktit se përshkruhet si një person tepër modest, kur janë në pyetje kundërvëniet e shqiptarëve ndaj pushtetit kur janë pyetje të drejtat e shqiptarëve. Vet ai duke diskutuar mbi ngjarjet e 1968'ës gjithnjë ka vënë në dukje se organizatori i Demonstratave të vitit 1968 ishte populli.

Faik Mustafa në cilësinë e organizatorit të Demonstratave do të burgoset dhe do të dënohet me 5 vjet e gjysëm (5,5 vjet) heqje lirie. Pas tre viteve të vuajtjes së burgut, do të vazhdojë studimet në Prishtinë, ku do të diplomojë më 1975.

Si student i Prishtinës, iu mundësua të punojë si gazetar në "Botën e Re" prej nga do të largohet me tërë stafin e redaksisë pas tri vitesh. Pas kësaj do të punësohet në të

përditshmen “Rilindja” (sipas konkursit), prej nga si ish i dënuar pra, në mungesë të cilësive morale – poitike, s’do ta lejojmë të vazhdojë punë.

Duke u bazuar në të dhënat që janë në dispozicion ky punim ka për qëllim të hedh dritë mbi figuratë emblemore të ngjarjeve të vitit 1968 në Tetovë, ndaj edhe si një përpjekje modeste synon që të vë theksin mbi idetë që përkojnë me veprimitarinë kombëtare të shqiptarëve të Maqedonisë në ish sistemin federativ të Jugosllavisë.

*Fjalë kyçë: Faik Konica, gazeta shqiptare, burgim.*

-----

Faik Mustafa u lind më 19 maj 1945, në Tetovë. Shkollën fillore dhe gjimnazin e kreu në vendlindje. Studimet i filloi në Fakultetin Filologjik në Beograd – grupi i Albanologjisë. Pas vuajtjes së dënimit me burg si organizator i demonstratave të vitit 1968 në Tetovë, i vazhdoi dhe i përfundoi studimet në Universitetin e Prishtinës. Ka punuar (me shkëputje) mësimdhënës i gjuhës shqipe në fshatrat Grupçin, Shipkovicë dhe Sellcë të Tetovës, si dhe një vit shkollor në Gjimnazin e Vitisë. Kohën tjetër të punës e ka kaluar në gazetari.

Pos që ka bashkëpunuar me shumicën e gazetave dhe revistave, që aso kohe botoheshin në gjuhën shqipe, si: “Bota e Re”, “Rilindja”, “Shkëndija”, “Zani i rinisë”, etj., Faik Mustafa katër vjet ishte korespondent i “Zërit të Amerikës” nga Maqedonia, 4 vjet kryeredakto i të përditshmes “Flaka” në Shkup dhe dy vitet e fundit para pensionimit ishte drejtori i Pallatit të Kulturës në Tetovë.

Për shkak të veprimitarisë atdhetare, ishte i ndjekur dhe i përndjekur nga ish-sistemi sllavo – komunist, duke e larguar nga puna.

Është e vërtetë se Faik Mustafa është njëri ndër organizatorët e demonstratave të vitit 1968, në 22 – 23 dhjetor 1968, në Tetovë. Personalisht, unë (Nebi Dervishi) e kam njojur nga afër dhe kemi bashkëbiseduar me këtë veprimitarë të palodhur i cili në mes tjerash thoshte: “...Është e vërtetë se jam njëri ndër organizatorët e demonstrave të vitit 1968. Këto demonstrata, pa i mohuar meritat e individëve (meqë dikujt i bie në hise t’i organizojë), me bindje të thellë e them se meritat për këtë, në rend të parë i takojnë popullit, ai pasviteve 1945, ka hequr të zitë e ullirit sa, për t’i ndriçuar të gjitha, nevoiten vepra e vepra. Pra, 1968-ta do të mbahet mend si viti i demonstratave të rinisë studentore evropiane, të cilat ngritën zérin për përmisimin e kushteve në studime dhe konvikte. Këto demonstrata, ku u përfshinë edhe studentët shqiptarë në Beograd, moment ky që do të na bashkojë që edhe ne të këndellemi të mendojmë për organizimin tonin. Pjesa dërmuese e asaj rinie, mund të them ka qenë e artë, idealiste e pashoqe, e gatshme për të dhënë gjithçka, për të shtuar kërkesa të drejta dhe të guximshme për të shtruar kërkesa të drejta dhe të guximshme përfitimin e Statusit të popullit të barabartë me të tjerë në ish-Jugosllavi.

Demonstratat ndodhën, jo sipas parashikimeve (në një takim konspirativë në Prishtinë). Marrëveshja ishte që ato të mbahen në të njëjtën ditë në të gjitha qytetet e populluara me shumicë shqiptare dhe me kërkesa identike. Ta kujtojsh atë kohë delikate, jo të harxhohet, por të mësohet, pa harxhuar shumë mund e kohë. Energjitet t’i shpenzojmë në kohën e sotme, në politikën e çoroditur, ku kemi menduar se kemi zgjedhur njerëzit më trima, më bujarë, më atdhetarë....”

Në vitin 1968, ne shënonim 500 vjetorin e vdekjes së Skenderbeut dhe kemi organizuar manifestim të jashtëzakonshëm. Beograzi ka qenë qyteti ku u formuan me shqiptarët e

Maqedonisë që studjonin atje. Pas rënies së A. Rankoviqit atje mbretëronte një klimë shumë e mirë dhe një liri më e madhe veprimi. Në kontakt dhe bashkëveprim me vëllezërit nga Kosova, të cilët në aspektin e ngritjes kombëtare ishin shumë përpara nesh, filluan xixat e para për të bërë diçka. Ishte viti i demonstratave në gjithë Evropën dhe botën. Pasi u morën vesh që të organizojmë demonstrata në të gjitha qytetet e populluara e shqiptarë, mua (Faik Mustafa) mu caktua detyra që të kthehem në Tetovë. Ndërsa, në demonstratat e Beogradit kërkoheshin kushte më të mira për studime, demokraci, etj., në viset tona kërkuesat ishin edhe me ngjyri me kombëtare. Në Tetovë u kërkua përdorimi i barabartë i gjuhës shqipe, përdorimi i simboleve kombëtare, punësimi dhe universitet në gjuhën shqipe, atëherë mendonim për universitet në Prishtinë, e cila kërkuesë edhe u realizua më vonë. Kërkuesat ishin të shëndosha, por u keqkuptuan dhe u shpallën armiqësore.

Demonstrata në Tetovë ishte masovike. Shqiptarët u liruan nga ajo frikë që regjimi kishte mbjellë që nga viti 1945 e këndej përmes burgosjeve, torturave, shpërnguljes për në Turqi, mbledhjes së armëve, heqja e feroxhesë, etj. Mund të them me plotë gojën se, fryti i demonstratave të vitit 1968 ishte vazhdimësi e gjeneratave para nesh, sepse gjithnjë ishte punuar për çështje kombëtare, për përparimin e arsimit, gjuhës, artit, kulturës dhe e do të jemi vazhdimësia e atyre. Kur filloi gjykimi e shtronin pyetjen. Kush jeni Ju të mendoni për arsimin shqip. Na akuzuan për armiq. Sigurisht që kemi pasur mungesë përvoje. Kërkuesat që i kishin shkruar nëpër pankarta nuk arritën t'i paraqesim si duhet se nga çdo anë vinin grupe të ndryshme krye me vete dhe secili grup e shprehte pakënaqësinë dhe revoltën në mënyrën e vet. Edhe niveli arsimor i grupeve ishte laraman nga aspekti arsimor. Megjithatë, vazhdon z. Faiku, për mua do të mbetet moment i paharrueshëm kur në sheshin e Tetovës, ku siç shprehet populli, as gjylpana nuk kishte ku të binte nga pjesëmarrësit e shumtë në shtizën mas qytetit, një djalosh hipë dhe e vuri flamurin kombëtar. I shikoja pleqtë të cilët me lot në sy përqafohen në mes veti. Ishin moment të paharrueshme që nuk zgjatën shumë, sepse pas 2-3 orësh filloj ora policore, dhuna e ashpër, jo vetëm ndaj organizatorëve, por edhe kundër masës populllore që kishte marrë pjesë në këtë demonstratë”.

Jehona e demonstratës në Tetovë (22-23 dhjetor 1968) ishte shumë e madhe, sepse nuk kërkoni asgjë të jashtëzakonshme. Të kërkosh të arsimohesh në gjuhën tënde, barabarsi të gjuhës tënde, etj. Kjo në perëndim hasi në shumë përkrahje sesa në keqkuptim. Kjo do të bëjë që edhe dënimet mos të janë ashtu siç i kishin paraparë autoritetet si dënlime të përjetshme. Ose me 10 e 15 vjet. Dënim më i lartë do të jetë 7 vjet për Mehmetriza Gegën, Faik Mustafa 5 vjet e gjysmë, nga të cilat i vuan 3 vjet, etj. Familjartë e të burgosurve disa herë do të shkojnë në Beograd të kërkojnë lirimin e tyre, dhe më në fund arritën të zbardhin të vërtetën e demonstratës, me çka edhe pasojë edhe lirimi i shumicës së të burgosurve dhe të arrestuarve.